



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZLAnr.107/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Hajriz Hoti kryesues, Violeta Husaj Rugova dhe Bujar Muzaqi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Subjektit Politik Za Slobodu Pravdu Opstanak me seli në Graçanicë, të paraqitur kundër Subjektit Politik, Lista Serbe, me seli në Mitrovicën e Veriut, për shkak të Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë Fushatës Zgjedhore, për Zgjedhjet Lokale, që do të mbahen më datë 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 08.10.2025, merr këtë,

V E N D I M

Hedhet e pasafatshme ankesa e subjektit politik Za Slobodu Pravdu Opstanak, me seli në Graçanicë, ZLAnr.107/2025, e datës 05.10.2025, e parashtruar kundër subjektit politik Lista Serbe me seli në Mitrovicën e Veriut, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë Fushatës Zgjedhore për Zgjedhjet Lokale, që do të mbahen më datë 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Me datë 05.10.2025 PZAP-i, ka pranuar ankesë nga Za Slobodu Pravdu Opstanak, me seli në Graçanicë, me të cilën pretendohet se aktivistët e subjektit politik SPO, kanë vërejtur se në profilin në Instagram të Subjektit Politik Srpske Demokratije, Vladimir Radosavljević, kandidat për kryetar komunë të Leposaviqit, transmetoi një video lidhur me blerjen e votave nga ana e Srpska Lista, në të cilën duket se po shpërndahen pako dhe po shkelet vullneti i votuesve nga ana e Srpska Lista në komunën e Leposaviqit. Më tej në ankesë theksohet se në fund të videos shihet personi i cili mori pakon dhe e konfirmoi se duhet të votohet për Srpska Lista, me çka është shkelur ligji 06/L-074, konkretisht neni 210 dhe neni 212, në lidhje me shkeljen e vullnetit të lirë të votuesit si dhe dhënien ose marrjen e mitës në lidhje me votimin. Parashtruesi i ankesës kërkon që PZAP të miratojë ankesën si të themeltë, të marrë VENDIM me të cilin ndëshkohet subjekti politik Srpska Lista-Zlatan Elek në përputhje me normat dhe rregullat ligjore lidhur me fushatën zgjedhore.

PZAP-i më datë 06.10.2025, i ka dërguar kërkesë për përgjigje Subjektit Politik Srpska Lista, duke i caktuar afatin deri më 07.10.2025 në ora 10:00, për përgjigje, mirëpo e njëjta në afatin e paraparë, e as më pas nuk ka paraqitur përgjigje ankesë.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën, provat e bashkangjitura të njëjtës, dhe pas hetimit në rrjetin social Instagram nga Paneli lidhur me pretendimin ankimor, vëren se ankesa është e pasafatshme.

Paneli, pas shqyrtimit të ankesës ka gjetur se ankesa e parashtruar nga subjekti politik Za Slobodu Pravdu Opstanak me seli në Graçanicë, kundër subjektit politik Lista Serbe, është parashtruar pas afatit ligjor të përcaktuar me dispozitën ligjore të nenit 39 paragrafi 3 i LZP-së, në të cilin nen përcakton se *“Personi i cili ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-it, ose të drejtat e të cilit janë shkelur për sa i përket shkeljeve të pretenduara të Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët gjatë periudhës së fushatës zgjedhore dhe ditës së zgjedhjeve, mund të paraqes ankesë në PZAP brenda dyzet e tetë (48) orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar, dhe PZAP-i, do të vendos për ankesën brenda shtatëdhjetë e dy (72) orëve nga koha e pranimi të saj.”* Kurse me nenin 13, paragrafi 3, nën paragrafi 3.2 i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, përcaktohet se *“PZAP-i e hedhë ankesën kur vlerëson se ajo nuk përmbush kërkesat e LZP-së... nuk është dorëzuar në afatin e paraparë ligjor”.*

Në rastin konkret nga provat e prezantuara nga ankuesi nuk është specifikuar data e publikimit në rrjetin social Instagram ndaj të cilit është ushtruar ankesa, meqenëse nuk është dëshmuar nga parashtruesi i ankesës data e publikimit të videos, Paneli, konform nenit 13 paragrafi 7 të Rregullores Nr.01/2025, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, me të cilin është përcaktuar se *“Paneli para se të vendos lidhur me ankesën mund të kryej hetim nëse e konsideron të nevojshme dhe të arsyeshme.”* Andaj Paneli ndërmori hetim lidhur me pretendimet e paraqitësit të ankesës dhe gjeti se e njëjta është e pasafatshme, pasi që nga hulumtimi dhe verifikimi në rrjetin social Instagram të kandidat për kryetar komune të Leposaviqit Vladimir Radosavljević nga subjekti politik Srpske Demokratije, shihet se ka bërë publikimin me datë 30 Shtator 2025, me çka vërtetohet se ankesa e parashtruesit të ankesës është paraqitur pas afatit ligjor prej 48 orësh.

Me dispozitën e nenit 9 paragrafi 5 i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, parashihet që *“Personi mund të paraqes ankesë në PZAP, brenda dyzet e tetë (48) orëve për shkeljet e pretenduara”.* Pra, nga shqyrtimi i shkresave të lëndës, vërtetohet fakti se postimi në rrjetin Social në Instragram është postuar më datë 30.09.2025, ndërsa ankesa është dorëzuar në PZAP më datë 05.10.2025, që do të thotë se njëjta është paraqitur pas afatit ligjor ankesa është parashtruar pas afatit ligjor për paraqitjen e ankesave, sipas nenit 39, paragrafi 3 i LZP-së, prej 48 orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar.

Paneli gjeti se ankesa është parashtruar pas afatit ligjor, dhe duke u bazuar në nenin 118 paragraf 1 të LZP-së, dhe nenin 13 paragrafi 3 pika 3.2 të Rregullës 01/2025, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
ZL.Anr.107/2025 datë 08.10.2025

Kryesues i Panelit
Hajriz Hoti



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.